



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME

P.A.nr.1/2026

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Delushe Halimi kryetare e kolegjit, Franciska Zhitija - Ymeri dhe Faton Bajrami anëtar të kolegjit, me bashkëpunëtoresh profesionale Zanë Buçinca, në çështjen juridike në konflikt administrativ sipas padisë së paditësit: Sh. S., fshati B., V., të cilin e përfaqëson Gani Avdiu, avokat nga Vushtrria, sipas autorizimit, kundër të paditurës: Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve (MFPT) - Departamenti i Pensioneve, me seli në Prishtinë, të cilën e përfaqëson R. O., nga Ministria e Drejtësisë - Avokatura Shtetërore, për shfuqizimin e pjesshëm të aktit nënligjor normativ - paragrafit 5 të nenit 5 të Udhëzimit Administrativ Nr.09/2015 (MPMS), për Kategorizimin e Shfrytëzuesve të Pensionit Kontributpagues sipas Strukturës Kualifikuese dhe Kohëzgjatjes së Pagesës së Kontributeve - Stazhit Pensional, i publikuar në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, më datë 31.12.2015, në shqyrtimin gjyqësor publik, të mbajtur në praninë e palëve ndërgjyqëse, më datë 17.03.2026, merr këtë:

A K T G J Y K I M

- I. Aprovohet e themeltë kërkesëpadia e paditësit: Sh. S., nga fshati B., V., e paraqitur kundër të paditurës: Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve (MFPT) - Departamenti i Pensioneve, me seli në Prishtinë.
- II. Shpallet i paligjshëm dhe shfuqizohet paragrafi 5 i nenit 5 të Udhëzimit Administrativ Nr.09/2015 (MPMS), për Kategorizimin e Shfrytëzuesve të Pensionit Kontribut pagues sipas Strukturës Kualifikuese dhe Kohëzgjatjes së Pagesës së Kontributeve - Stazhit Pensional, i publikuar në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, më datë 31.12.2015.
- III. Detyrohet e paditura: Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve (MFPT) - Departamenti i Pensioneve, me seli në Prishtinë, që paditësit t'ia kompensoj shpenzimet e procedurës së konfliktit administrativ, në shumë të përgjithshme prej 618 (gjashtëqind e

tetëmbëdhjetë) Euro, në afat prej 15 ditësh pas pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarrimit të detyrueshëm.

IV. Ky aktgjykim merr formën e prerë menjëherë pas komunikimit të përmbajtjes dhe arsyetimit të tij palëve, dhe publikohet në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

A r s y e t i m

I. Historiku procedural dhe pretendimet e palëve ndërgjyqëse

Paditësi: Sh. S., nga V., më datë 05 janar 2026, në Gjykatën Supreme të Kosovës, ka ushtruar padi kundër të paditurës: Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve (MFPT) - Departamenti i Pensioneve, me seli në Prishtinë, për shfuqizimin e pjesshëm të aktit nënligjor normativ, përkatësisht dispozitës së veçantë të tij, paragrafit 5 të nenit 5, të Udhëzimit Administrativ Nr.09/2015 (MPMS), për Kategorizimin e Shfrytëzuesve të Pensionit Kontributpagues sipas Strukturës Kualifikuese dhe Kohëzgjatjes së Pagesës së Kontributeve - Stazhit Pensional, të publikuar në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, më datë 31.12.2015.

Paditësi me padi, gjatë seancës së shqyrtimit gjyqësor dhe në fjalën përfundimtare nëpërmes të autorizuarit të tij, ka kërkuar nga Gjykata Supreme e Kosovës, që të aprovohet në tërësi kërkesëpadia, të shpallet i paligjshëm dhe të shfuqizohet paragrafi 5 i nenit 5 të aktit nënligjor normativ të kontestuar. Paditësi pretendon se, ka kualifikim universitar superior, sepse me datën 15 shkurt 1991 ka diplomuar në Fakultetin Juridik të Universitetit të Prishtinës dhe ka marrë kualifikimin Jurist i Diplomuar. Paditësi ishte në marrëdhënie pune në ish Ndërmarrjen Shoqërore “Dardania” në Prishtinë, nga data 02.03.1981 deri më datën 17.11.2006, në vendin e punës: Sekretar i Ndërmarrjes përkatëse, me kualifikim të lartë deri më datën 15.02.1991, kurse me kualifikim superior: Jurist i Diplomuar, nga data 15.02.1991. Në bazë të kësaj diplome, paditësi, pas privatizimit të Ndërmarrjes “Dardania”, me datën 01.12.2010, ka themeluar marrëdhënien e punës në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare në Vushtrri, në vendin e punës: Shef i Departamentit Juridiko-Administrativ, në kohë të pacaktuar. Në këtë vend të punës i njëjti ka punuar deri më 15 maj 2017, kur e ka arritur moshën për pensionim. Paditësi e ka fituar të drejtën në pension kontributpagues, nga data 15.05.2017, por nga e paditura nuk i është njohur e drejta e përlllogaritjes së pensionit në bazë të kualifikimit

superior: Jurist i Diplomuar, me arsyetim se ka diplomuar pas datës 01.01.1991. Me nenin 4.1 të UA 09/2015 të MFPT - Departamenti i Pensioneve (ish MPMS), është përcaktuar: *“Kategorizimi i shfrytëzuesve të pensionit kontributpagues, sipas strukturës kualifikuese, ndahet në katër (4) kategori: 1.1 pensionistët me përgatitje shkollore të ulët; 1.2 pensionistët me përgatitje shkollore të mesme; 1.3 pensionistët me përgatitje shkollore të lartë dhe 1.4 pensionistët me përgatitje shkollore superiore“*. Me nenin 5, par. 1, 2, 3 dhe 4 të UA 09/2015 të (MPMS), është përcaktuar se çka konsiderohet pensionist kontributpagues me përgatitje shkollore: të ulët, të mesme, të lartë dhe superiore. Me paragrafin 5 të nenit 5, të aktit nënligjor normativ: UA 09/2015 të MPMS, është përcaktuar: *“Të gjitha dëshmitë për kualifikim, të përcaktuara nga paragrafët 2, 3 dhe 4 të këtij neni, duhet të jenë para vitit 01.01.1991”*. Pa marrë parasysh faktin se pensionisti kontributpagues a ka punuar pas datës 01.01.1991 në bazë të kualifikimit të mesëm, të lartë dhe superior në kuptim të paragrafëve 2, 3 dhe 4 të nenit 5 të aktit të përgjithshëm nënligjor të lartcekuar. Paditësi konsideron se me paragrafin 5 të nenit 5 të UA të MPMS 09/2015, të datës 31.12.2015, pa bazë ligjore është kufizuar vlefshmëria kohore e diplomës universitare, duke cilësuar si bazë të vlefshme për përllogaritje të pensionit kontributpagues kualifikimin e mesëm, të lartë dhe superior vetëm për ata persona që kanë fituar këtë kualifikim deri më datën 01.01.1991. Tutje, thekson se, duke vendosur një kusht të paparaparë me dispozitat ligjore të ligjeve që rregullojnë çështjen e pensioneve (Ligji Nr. 04/L-131 për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti, e as me Ligjin Nr. 08/L-248 për Ndryshimin dhe Plotësimin e të njëjtit ligj), është cenuar e drejta e fituar, si pasojë e diskriminimit arbitrar me efekt *“erga omnes”* për të gjithë pensionistët kontributpagues, përfshirë edhe paditësin, të cilët kanë arritur kualifikim shkollor: të mesëm, të lartë dhe superior pas datës 01.01.1991, duke mos iu llogaritur kualifikimi përkatës në lartësinë e pensionit të fituar kontributpagues.

Në vazhdim paditësi pretendon se: Me këtë akt nënligjor, paditësit i është cenuar e drejta e tij për trajtim të barabartë para ligjit, e sanksionuar me nenin 24 të Kushtetutës, duke ia mohuar të drejtën për përllogaritjen e lartësisë së pensionit në bazë të kualifikimit superior, në bazë të të cilit ka punuar nga data 15.02.1991 si ditë e diplomimit, në vendin e punës Sekretar juridik në N.SH. *“Dardania”* e deri më datën 01.01.1999 dhe ishte në marrëdhënie pune deri më datën 17.11.2006. Me këtë akt normativ nënligjor është cenuar rendi juridik i përcaktuar sipas fuqisë së akteve juridike: 1) Kushtetuta, 2) Ligji dhe 3) aktet nënligjore (udhëzime administrative, rregullore, vendime), sepse paditësit me akt nënligjor normativ i është kufizuar e drejta e vlefshmërisë së diplomës universitare, përkatësisht kualifikimit superior, në pikëpamje kohore

pa bazë ligjore. Me akt nënligjor nuk mund të vendosen kushte shtesë për njohjen e kualifikimit superior, nëse këto kushte nuk parashihen me ligj, pra me këtë akt nënligjor është cenuar siguria juridike, duke shkaktuar diskriminim arbitrar ndaj paditësit me cenimin e të drejtës së fituar. Diploma e paditësit është lëshuar nga institucioni publik arsimor kompetent dhe në bazë të ligjit, dhe si e tillë përbën të drejtë të fituar, e cila nuk mund të mohohet me akt normativ nënligjor të kundërligjshëm të nxjerrë më vonë, me efekt retroaktiv, si në rastin konkret.

Me parashtresën e datës 09.03.2026, kundërpërgjigje ndaj pretendimeve të theksuara si në përgjigje në padi, paditësi ka theksuar se: Paditësi ka bërë ndryshimin e padisë në kuptimin subjektiv, ku si palë e paditur është Ministria e Punës, Familjes dhe Vlerave të Luftës Çlirimtare, në të cilën, sipas përbërjes së kabinetit aktual qeveritar, ka kaluar edhe çështja e pensioneve. Tutje, ka kundërshtuar si të paqëndrueshëm pretendimin e të paditurës të dhënë me rastin e përgjigjes në padi, se çështja e ngritur me padi në këtë gjykatë ka vendosur Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës me Aktgjykimin KO190/19, të datës 16 janar 2023. Lidhur me këtë çështje, përkatësisht me nenin 5.5 të aktit nënligjor të atakuar me padi, Gjykata Kushtetuese nuk ka vendosur fare, pra nuk është pjesë e vendimmarrjes (refuzuese e as aprovuese) në dispozitiv të aktgjykimit të saj. Ka shtuar se: ligji nuk e kushtëzon njohjen e kualifikimit arsimor, përfshirë edhe atë superior, me një datë të përcaktuar (para datës 1.1.1991), si kusht për llogaritjen e lartësisë së pensionit kontributpagues të moshës. Sistemi i sigurimeve pensionale i rregulluar me Ligjin e KSAK të lartcekuar, e ka njohur paditësin si person të kualifikuar me kualifikim superior gjatë periudhës kontributpaguese. Ministria, me aktin nënligjor (të atakuar), po e mohon atë kualifikim vetëm për shkak të datës së diplomimit, pra se paditësi ka diplomuar (me datën 15.02.1991), pra pas datës 1.1.1991. Ligji (neni 8) kërkon kontribute deri më datën 1.1.1999, e jo diplomim para datës 1.1.1991. Kushti i ri nuk është i përcaktuar me ligj, por me akt nënligjor normativ të Ministrisë. Andaj, Ministria me aktin nënligjor normativ, pra me paragrafin 5 të nenit 5 të UA nr. 09/2015, ka shkelur nenin 8 të Ligjit për Skemat Pensionale të Financuara nga shteti, sepse pa bazë ligjore ka krijuar normë materiale, duke kërkuar një kusht të ri për shkallën e kualifikimit profesional, sipas të cilit personi duhet të ketë diplomë të shkollimit të mesëm, të lartë apo superior para datës 1.1.1991. Me paragrafin 2 të nenit 8 të ligjit përkatës, Ministria është autorizuar që me akt nënligjor normativ të përcaktojë kategoritë e shfrytëzuesve të pensioneve kontributpaguese, sipas përgatitjes shkollore, dokumentacionin e nevojshëm dhe mënyrën e realizimit të kësaj të drejte, por jo edhe të përcaktojë kufizimet kohore të diplomave të nivelit arsimor, duke

përcaktuar një datë vlefshmërie vetëm për ato diploma që janë fituar para datës 1.1.1991. Me një akt të tillë, kufizohet një kategori përfituesish të pensionit kontributpagues të moshës, të cilët kanë arritur përgatitje shkollore pas datës 01.01.1991, që ligji nuk e përcakton dhe në bazë të këtij kualifikimi kanë realizuar pagë dhe kanë paguar kontribute deri më datën 01.01.1999, duke përmbyshur stazhin pensional kontributpagues të paraparë me ligj. Paragrafi 2 i nenit 8 i jep Ministrisë të drejtën që me akt nënligjor të përcaktojë kategoritë e përfituesve dhe mënyrën e realizimit të të drejtës. Kjo do të thotë se Ministria mund të rregullojë procedurën, të specifikojë dokumentacionin, të bëjë kategorizimin sipas nivelit arsimor apo stazhit, por brenda kufijve të ligjit. Pra, në kuptim të par. 2 të nenit 8 të ligjit përkatës, nuk ishte përcaktuar një afat i tillë për vlefshmërinë e diplomës shkollore e as universitare dhe as Ministria nuk ishte autorizuar me ligj të përcaktojë afat për vlefshmërinë e diplomës për kualifikim arsimor. Andaj, Ministria, duke përcaktuar një afat të tillë me paragrafin 5 të nenit 5 të UA nr. 09/2015, të datës 31.12.2015, ka krijuar normë materiale, duke tejkaluar autorizimin ligjor (ultra vires), me caktimin e datës së vlefshmërisë së diplomës për kualifikim arsimor vetëm për të diplomuarit para datës 01.01.1991.

Ka shtuar se: Me akt nënligjor nuk mund të kufizohet një e drejtë që ligji e ka dhënë, nuk mund të shtohen kushte që ligji nuk i parasheh. Në të kundërtën, akti nënligjor do të kishte efekt ndryshues ose plotësues të ligjit, gjë që juridikisht është e papranueshme. Andaj, Ministria nuk ka pasur autorizim të krijojë me akt nënligjor një kufizim substancial që ligji nuk e njeh. Paragrafi 2 i nenit 8 lejon vetëm rregullim teknik të realizimit të të drejtës, jo ndryshim të përmbajtjes së saj materiale. Vendosja e datës 01.01.1991 përbën tejkalim kompetence dhe cenim të së drejtës së fituar mbi bazën e kontributeve të paguara deri më 01.01.1999. Pra, me paragrafin 5.5 të UA të atakuar është cenuar parimi i sigurisë juridike dhe cenimi i pritjes legjitime të kontributpaguesve sipas kualifikimit shkollor, për stazhin pensional deri më datë 01.01.1999.

Në fund, paditësi ka kërkuar nga Gjykata Supreme e Kosovës, që të nxjerr aktgjykim me të cilin: I. Aprovohet e themeltë kërkesëpadia e paditësit Sh. S., me vendbanim në fshatin B., Komuna V., e paraqitur kundër të paditurës: Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve (MFPT) - Departamenti i Pensioneve me seli në Prishtinë. II. Shpallet i paligjshëm dhe shfuqizohet paragrafi 5 i nenit 5 i aktit nënligjor normativ: Udhëzimi Administrativ 09/2015 datë 31.12.2015 i (MPMS), për kategorizimin e shfrytëzuesve të pensionit kontributpagues, sipas strukturës kualifikuese dhe kohëzgjatjes së pagesës së kontributeve - stazhit pensional.

III. Detyrohet e paditura t'ia paguajë paditësit shpenzimet procedurale, të cilat do të përcaktohen brenda afatit ligjor. Pagesa bëhet në llogarinë bankare të paditësit, brenda 15 ditëve nga dorëzimi i kopjes së këtij aktgjykimi, nën pasojat e përmbarimit të detyrueshëm.

Gjykata, pasi ka caktuar dhe mbajtur seancën e shqyrtimit gjyqësor më datë 17.03.2026, e ka shqyrtuar këtë konflikt administrativ në pajtim me nenin 58 dhe 59 të Ligji Nr. 08/L-182 Për Konfliktet Administrative, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës / Nr. 3 / 10 Janar 2024, Prishtinë, (tutje: LKA-së), në praninë e palëve ndërgjyqëse.

Përfaqësuesi i autorizuar i të paditurës me përgjigje në padi, dhe në seancën e shqyrtimit gjyqësor, ka theksuar se: Akti nënligjor kontestues është i bazuar në legjislacionin primar dhe sekondar specifik dhe është trajtuar nga instanca më e lartë kushtetuese dhe si i tillë padia e paditësit duhet të hidhet si e palejuar në bazë të nenit 38 të Ligjit për Konfliktet Administrative, lidhur me nenin 25, paragrafi 6 të Ligjit për Konfliktet Administrative, i cili përcakton: *“Padia për shfuqizimin e një akti nënligjor normativ nuk mund të ngrihet nëse për kushtetutshmërinë e të njëjtit akt nënligjor normativ apo përkatësisht dispozitës së tij ka vendosur Gjykata Kushtetuese...”*. Paditësi nuk ka treguar dispozitën konkrete ligjore me të cilën është në kundërshtim dispozita e U.A. 09/2015 që është kërkuar të shfuqizohet. E paditura MFPT - si organ i autorizuar me Ligjin për Pensionet sipas nenit 8, paragrafi 2, ka nxjerrë aktin nënligjor U.A Nr. 09/2015, sipas të cilit është përcaktuar kategorizimi i shfrytëzuesve të pensionit kontributpagues, sipas kohëzgjatjes së pagesës së kontributeve, në bazë të strukturës kualifikuese dhe kriterëve të tjera. Ligji për Pensionet ka përcaktuar se duhet të nxirret një akt nënligjor me të cilin përcaktohen këto kategorizime, atëherë kuptohet që është vendosur të rregullohet me akt nënligjor dhe nuk ka tejkalim të kompetencave. Në nenin 8 të këtij ligji *“Kushtet dhe kriteret për njohjen e të drejtës në pension kontributpagues të moshës”*, citohet si në vijim: *“1. Të drejtë në pension kontributpagues të moshës e realizojnë të gjithë personat të cilët kanë shtetësi të Kosovës dhe të cilët: Kanë mbushur moshën gjashtëdhjetë e pesë (65) vjeçare; Duhet të kenë stazh pensional kontributpagues, sipas Ligjit për Sigurime Pensionale dhe Invalidore Nr. 011-24/83 (Gazeta Zyrtare KSAK Nr. 26/83) para datës 01.01.1999; Ofrojnë dëshmi të vlefshme mbi pagesën e kontributeve sipas dispozitave të Ligjit për Sigurimin Pensional dhe Invalidor Nr. 011-24/83 (Gazeta Zyrtare e KSAK nr. 26/83) para datës 01.01.1999.”* Dispozita e mësipërme zbatohet qartësisht edhe për pensionet kontributpaguese. Pra ligjërisht ekziston autorizimi për nxjerrjen e një akti nënligjor me të cilin do të rregullohen kushtet dhe kriteret për pensionet kontributpaguese. Pretendimet e

paditësit nuk qëndrojnë sepse ky UA vlen për të gjithë përfituesit e pensionit kontributpagues dhe ndaj tij nuk është bërë asnjë lloj diskriminimi, sepse i njëjti është nxjerrë brenda kompetencave që i ka paraprirë edhe vetë Ligji për Skemat Pensionale. Në këtë kuadër, në përputhje me autorizimet ligjore të mësipërme, Ministria ka nxjerrë Udhëzimin Administrativ të konstatuar, ku veç të tjerash ka përcaktuar edhe kushtet dhe kriteret për këtë lloj të pensionit. U.A është akt nënligjor i ligjshëm, i nxjerrë në përputhje me kompetencat e Ministrisë dhe nuk krijon norma të reja materiale, por rregullon vetëm aspektet procedurale të zbatimit të ligjit për çka ka autorizim nga Ligji për Pensionet. Pretendimet dhe kërkesa për *“shfuqizim të pjesshëm të UA si i paligjshëm”*, janë të pabazuara, sepse U.A nuk bie ndesh me dispozitat e ligjeve që rregullojnë pensionet kontributpaguese, në të kundërtën U.A është nxjerrë në bazë të nenit 8 të Ligjit Nr. 04/L-131 për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti. Rrjedhimisht, Udhëzimi Administrativ është akt i zbatimit të ligjit, jo akt që tejkalon kompetencat apo që ndryshon përmbajtjen materiale të ligjit. Procedurat e parashikuara me Udhëzimin Administrativ kanë për qëllim të përcaktojnë kushtet dhe kriteret për kategorizimin e pensionistëve kontributpagues, duke u bazuar në strukturën kualifikuese dhe kohëzgjatjen e pagesave të kontributeve pensionale.

Andaj, e paditura duke pasur parasysh thëniet e cekura më lart, i propozon Gjykatës që të marrë: aktvendim me të cilin: Hedhet si e palejuar padia e paditësit për shkak se kjo çështje tashmë është trajtuar nga Gjykata Kushtetuese në mënyrë meritore. Në qoftë se Gjykata vlerëson të kundërtën, që të marrë aktgjykim me të cilin: Refuzohet në tërësi si e pabazuar padia dhe kërkesëpadia e paditësit për shkak të mungesës së bazës juridike në pretendimet e paditësit. Mbetet në fuqi Udhëzimi Administrativ Nr. 09/2015 të MPMS për kategorizimin e shfrytëzuesve të pensionit kontributpagues.

II. Vlerësimi i gjendjes faktike dhe provat e administruara

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, gjykata në procedurën e provave në seancën e shqyrtimit gjyqësor - publik të datës 17.03.2026, ka administruar provat relevante dhe atë: Udhëzimi Administrativ Nr.09/2015 (MPMS), për Kategorizimin e Shfrytëzuesve të Pensionit Kontributpagues sipas Strukturës Kualifikuese dhe Kohëzgjatjes së pagesës së Kontributeve - Stazhit pensional, i datës 31.12.2015; Letër Konfirmimi, nr.16166/2017, i datës 20.03.2017; Diplomë, nr.659, 10 shkurt 2004, në emër të paditësit; Kontratë pune nr.352, datë 24.05.2012, lidhur ndërmjet të Komuna e Vushtrrisë - QKMF, dhe paditësit; Kërkesë për pension kontributiv, nr.294967, datë 15.05.2017; Vendim i datës

05.07.2017, për paditësin; Vendim i datës 31.05.2017, për paditësin; Diplomë për kryerjen e shkollës së mesme nr.313021-1, nr.69, qershor 1974, për paditësin; Procesverbal i datës 17.12.2018; Formular në emër të paditësit për pranimin e të drejtës në rritjen e pensionit bazë kontributpagues, 15.05.2017; vërtetim për përvojën e punës dhe të ardhurat personale të realizuara (M -4); Kërkesë për pension bazë, 15.05.2017; Regjistrim i aplikantit për pension bazë; Vendim i datës 25.05.2017, për paditësin; Ekstrakt nga regjistri i gjendjes civile E21470242; Fatura e tatimit në pronë, datë 04.05.2017; Aktgjykim KO190/19 i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës.

Gjykata në pajtim me dispozitat ligjore të nenit 59 paragraf 8 të Ligjit nr.08/L-182 për Konfliktet Administrative, i publikuar në Gazetën Zyrtare më datë 10.01.2024, dhe ka hyrë në fuqi më datë 10.01.2025 (më tutje: LKA), ka shqyrtuar ligjshmërinë e aktit kontestues në drejtim të thënieve në padi, thënieve në seancë dhe pas shqyrtimit të shkresave të lëndës në këtë konflikt administrativ.

Nga shkresat e lëndës rezulton se: Ministri i Punës dhe Mirëqenies Sociale, më datë 31 dhjetor 2015, ka miratuar Udhëzimin Administrativ, Nr.09/2015 (MPMS), (nr.prot.414), për Kategorizimin e Shfrytëzuesve të Pensionit Kontributpagues sipas Strukturës Kualifikuese dhe Kohëzgjatjes së Pagesës së Kontributeve - Stazhit Pensional, i publikuar në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, më datë 31.12.2015.

Aktin nënligjor normativ të kontestuar, e ka nxjerr në mbështetje të nenit 8 paragrafit 2 të Ligjit Nr. 04/L-131 për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti, Ligjit Nr. 02/L-28 për Procedurën Administrative, nenit 8 paragrafit 1.4 të Rregullores Nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, si dhe nenit 38 paragrafit 6 të Rregullores Nr. 09/2011 për Punën e Qeverisë.

Ky Udhëzim Administrativ ka për qëllim të përcaktojë kushtet dhe kriteret për kategorizimin e pensionistëve kontributpagues, duke u bazuar në strukturën kualifikuese dhe kohëzgjatjen e pagesave të kontributeve pensionale.

III. Dispozitat relevante kushtetuese, ligjore dhe ndërkombëtare

Kushtetuta e Republikës së Kosovës, e publikuar në Gazetën Zyrtare më datë 09.04.2008, dhe ka hyrë në fuqi më 15.06.2008

Neni 102 [Parimet e Përgjithshme të Sistemit Gjyqësor], paragraf 3 përcakton: “Gjykatat gjykojnë në bazë të Kushtetutës dhe ligjit”.

Ligji Nr. 08/L-182 për Konfliktet Administrative, Gazeta Zyrtare Nr.3, i miratuar më 14 dhjetor 2023, dhe në fuqi nga data 10 janar 2025

Neni 3 [Përkufizimet]: “1. Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime: 1.1. Akt nënligjor normativ - një akt, i nxjerrë në bazë të autorizimit të shprehur të një ligji të miratuar nga Kuvendi, që përcakton rregulla të detyrueshme sjellje në mënyrë abstrakte dhe të përgjithshme”.

Neni 5 [Parimi i ligjshmërisë]: “Gjykata kompetente shqyrton konfliktin dhe vendos në bazë të Kushtetutës dhe ligjit”.

Neni 10 [Organizimi dhe Kompetenca]: “4. Gjykata Supreme, gjykon revizionin dhe si shkallë e parë dhe e vetme, padinë për shfuqizimin e një akti nën-ligjor normativ”.

Neni 11 [Përbërja në gjykim]: “3. Gjykata Supreme, gjykon lëndën në kolegji të përbërë prej tre (3) gjyqtarësh”.

Neni 13 [Llojet e padive]: “1. Në konfliktin administrativ, paditësi mund të kërkojë: 1.6. shfuqizimin e një akti nënligjor normativ (në tekstin e mëtejme “padia ndaj aktit nënligjor normativ”).

Neni 25 [Padia për shfuqizimin e aktit nënligjor normativ], “1. Me padinë për shfuqizimin e një akti nënligjor normativ, paditësi kërkon deklarin e paligjshmërisë të një dispozite të një akti nënligjor normativ apo të tërë aktit nënligjor normativ në tërësinë e tij dhe përkatësisht shfuqizimin e tyre. 2. Padia për shfuqizimin e një akti nënligjor normativ mund të ngrihet nëse një person fizik apo juridik pretendon se akti është në kundërshtim me ligjin dhe se për këtë shkak i cenon apo do ti cenojë në të ardhmen, të drejtat apo interesat e tij të ligjshëm. 5. Në padinë kundër aktit nënligjor normativ, i paditur, është organi publik që ka miratuar aktin. 6. Padia për shfuqizimin e një akti nënligjor normativ nuk mund të ngrihet nëse për kushtetueshmërinë e të njëjtit akt nënligjor normativ apo përkatësisht dispozitës së tij ka vendosur Gjykata Kushtetuese apo është paraqitur një kërkesë në këtë Gjykatë dhe nuk është dhënë ende një vendim. Nëse një kërkesë paraqitet në Gjykatën Kushtetuese gjatë zhvillimit të

gjykimit sipas këtij ligji, ai pezullohet deri në vendimin e Gjykatës Kushtetuese. 7. Padia për shfuqizimin e një akti nënligjor normativ paraqitet në çdo kohë për sa akti është në fuqi, madje edhe pas miratimit por para publikimit të detyrueshëm të aktit, për efekt të hyrjes të tij në fuqi”.

Neni 59 [Procedimi i padisë me objekt shfuqizimin e aktit nënligjor normativ]: “8. Në shqyrtimin e themelësisë së padisë, Gjykata vlerëson përmbajtjen, formën dhe procedurën për miratimin, shpalljen dhe hyrjen në fuqi të aktit nënligjor normativ të kontestuar.”

Ligji Nr. 04/L-131 për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti, i publikuar në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, më datë 05.06.2014

Neni 4 [Të drejtat e përcaktuara me këtë ligj]: “1. Për personat të cilët i plotësojnë kushtet dhe kriteret e përcaktuara sipas këtij ligji, sigurohen këto të drejta: 1.2. E drejta në pension kontributpagues të moshës.”

Neni 3 [Përkufizimet]: “1. Shprehjet e përdorura në këtë ligj kanë këtë kuptim: 1.5. Pension kontributpagues i moshës - pensioni i rregullt mujor për qytetarët e punësuar në Republikës e Kosovës, të cilët i kanë paguar kontributet, në ish-Fondin Pensional të Kosovës para datës 01.01.1999 sipas dispozitave të Ligjit për Sigurimin Pensional dhe Invalidor nr. 011-24/83 (Gazeta Zyrtare e KSAK-së nr. 26/83) e të cilët i plotësojnë kriteret e paraparë me këtë ligj.”

Neni 8 [Kushtet dhe kriteret për njohjen e të drejtës në pension kontributpagues të moshës]: “1. Të drejtën në pension kontributpagues të moshës e realizojnë të gjithë personat të cilët kanë shtetësi të Kosovës dhe të cilët: 1.1. kanë mbushur moshën gjashtëdhjetë e pesë (65) vjeçare; 1.2. duhet të ketë stazh pensional kontributdhënës, sipas Ligjit për Sigurimin Pensional dhe Invalidor nr. 011-24/83 (Gazeta Zyrtare e KSAK nr.26/83) para datës 01.01.1999; 1.3. ofrojnë dëshmi të vlefshme mbi pagesën e kontributeve sipas dispozitave të Ligjit për Sigurimin Pensional dhe Invalidor nr.011-24/83 (Gazeta Zyrtare e KSAK nr.26/83) para datës 01.01.1999. 2. Kategorizimi i shfrytëzuesve të pensionit kontributdhënës, sipas kohëzgjatjes së pagesës së kontributit sipas strukturës kualifikuese dhe kriterëve tjerë, përcaktohet me akt nënligjor, të cilin do ta miratojë ministria përkatëse. 3. Personat të cilët i plotësojnë kushtet dhe kriteret për pension kontributpagues të moshës, nuk mund të jenë edhe shfrytëzues të ndonjë skeme tjetër pensionale të përcaktuar me këtë ligj. 4. Përjashtimisht, shfrytëzuesit e pensionit kontributpagues të moshës, dhe shfrytëzuesit e pensioneve tjera të përcaktuara me këtë ligj, mund të jenë edhe shtetasit e huaj, me shtetin e të cilëve, Republika e Kosovës, lidh Marrëveshje Bilaterale për sigurimet sociale. 5. Dispozitat e Marrëveshjeve

Bilaterale të sigurimeve sociale, të cilat i lidh Republika e Kosovës me shtetet përkatëse, kanë epërsi ndaj dispozitave të këtij ligji dhe ligjeve tjera nga fusha e sigurimeve sociale. 6. Me këtë ligj u njohet stazhi i punës për pension kontributdhënës për vitet 1989-1999 punëtorëve të arsimit, të shëndetësisë dhe të tjerëve që kanë punuar në sistemin e Republikës së Kosovës.”

Ligji Nr.08/L-248 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-131 Për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti, të publikuar në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, më datë 16.08.2023

Neni 4 Pas nenit 8, shtohet dispozita ligjore 8/A në Ligjin Bazik me tekstin si në vijim: Neni 8/A [Pensioni parcial kontributpagues i moshës]: “1. Personat që kanë kontribuar sipas Ligjit për Sigurimin Pensional dhe Invalidor Nr. 011-24/83 (Gazeta Zyrtare e KSAK Nr. 26/83) para datës 01.01.1999 por nuk e arrijnë stazhin pensional prej pesëmbëdhjetë (15) vitesh kontribute si periudhë kushtëzuese për shkak se janë larguar nga puna si rezultat i masave të dhunshme, mund të kualifikohen në skemën e pensionit parcial kontributpagues të moshës sipas kriterëve dhe kushteve të përcaktuara në këtë nen. 2. Të drejtën në pension parcial kontributpagues të moshës e realizojnë të gjithë personat të cilët kanë shtetësi të Kosovës dhe të cilët plotësojnë kushtet në vijim: 2.1. kanë mbushur moshën gjashtëdhjetë e pesë (65) vjeçare; 2.2. ofrojnë dëshmi të vlefshme mbi pagesën e kontributeve sipas dispozitave të Ligjit për Sigurimin Pensional dhe Invalidor nr.011-24/83 (Gazeta Zyrtare e KSAK nr.26/83) para datës 01.01.1999; 2.3. janë larguar nga puna pas datës 01.01.1989 si rezultat i masave të dhunshme; 2.4. shuma e periudhës së kontributeve të paguara sipas nën-paragrafit 2.2 si dhe periudhës nga data e largimit të dhunshëm nga puna sipas nën-paragrafit 2.3 e deri më 01.01.1999 bashkërisht arrijnë nivelin prej pesëmbëdhjetë (15) vitesh. 3. Dokumentacioni i nevojshëm për të plotësuar kushtet e paragrafit 2 të këtij neni përcaktohet me akt nënligjor nga ministri. 4. Lartësia e pensionit parcial kontributpagues për secilin nivel përcaktohet në përputhje me procedurën e vendosur me nenin 13 të Ligjit Bazik, duke marrë për bazë numrin e viteve të kontributeve të paguara sipas nën-paragrafit 2.2 të këtij neni.”

Ligji për Sigurimin Pensional dhe Invalidor nr. 011-34/83 (Gazeta Zyrtare e KSAK nr.26/83, shpallur në “Gazetën Zyrtare të RSFJ-së”, nr. 23/82, 77/82, 75/85, 8/87, 65/87, 87/89, 44/90.

Neni 1 [Pa titull]: “Me këtë ligj më hollësisht rregullohen të drejtat themelore nga sigurimi pensional e invalidor në përputhje me Ligjin mbi të drejtat themelore nga sigurimi pensional e invalidor (“Gazeta zyrtare e RSFJ-së” nr. 23/82 dhe 77/82, në tekstin e mëtejshëm: Ligji

mbi të drejtat themelore) dhe rregullohen edhe të drejtat tjera themelore nga sigurimi pensional e invalidor. Ligji për të drejtat themelore të sigurimit pensional dhe invalidor 41/94)

Neni 21 [Pensioni i pleqërisë]: *“Punonjësi nga neni 18 deri 20 të këtij Ligji (në tekstin e mëtejshëm: i siguruari) fiton të drejtën për pensionin e pleqërisë kur mbush 60 vjet (mashkull), respektivisht 55 vjet (femër) të jetës dhe 20 vjet të stazhit të pensionit. I siguruari i cili nuk ka arritur stazhin e pensionit prej 20 vitesh e fiton të drejtën në pensionin e pleqërisë kur mbush 65 vjet (mashkull), respektivisht 60 vjet (femër) të jetës dhe së paku 15 vjet të stazhit të sigurimit. I siguruari e fiton të drejtën për pensionin e pleqërisë kur mbush 40 vjet (mashkull), respektivisht 35 vjet të stazhit të pensionit (femër), pavarësisht nga vitet e jetës.”*

Udhëzimit Administrativ Nr.09/2015 (MPMS), për Kategorizimin e Shfrytëzuesve të Pensionit Kontributpagues sipas Strukturës Kualifikuese dhe Kohëzgjatjes së Pagesës së Kontributeve - Stazhit Pensional, i publikuar në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, më datë 31.12.2015.

Neni 5 [Kualifikimi i shfrytëzuesve të pensionit Kontributpagues]: *“1. Shfrytëzuesi i pensionit kontributpagues me përgatitje shkollore të ultë, konsiderohet i siguruari ose pensionisti kontributpagues, pa ose me përgatitje shkollore të ultë. 2. Shfrytëzuesi i pensionit kontributpagues me përgatitje shkollore të mesme, konsiderohet pensionisti, përkatësisht i siguruari i cili ka të kryer shkollën e mesme. 3. Shfrytëzuesi i pensionit kontributpagues me përgatitje shkollore të lartë, konsiderohet pensionisti, përkatësisht i siguruari i cili e ka të kryer shkollimin e lartë. 4. Shfrytëzuesi i pensionit kontributpagues me përgatitje shkollore superiore, konsiderohet pensionisti, përkatësisht i siguruari i cili ka të kryer fakultetin apo studimet pasuniversitare 5. **Të gjitha dëshmitë për kualifikim, të përcaktuara nga paragrafët 2, 3 dhe 4 të këtij neni, duhet të jenë para vitit 01.01.1991.”***

IV. Vlerësimi i ligjshmërisë së aktit nënligjor normativ të kontestuar

Gjykata Supreme e Kosovës, për të vlerësuar ligjshmërinë e dispozitës së aktit nënligjor normativ të kontestuar, gjegjësisht paragrafit 5 të nenit 5 të Udhëzimit Administrativ Nr.09/2015 (MPMS), për Kategorizimin e Shfrytëzuesve të Pensionit Kontributpagues sipas Strukturës Kualifikuese dhe Kohëzgjatjes së Pagesës së Kontributeve - Stazhit Pensional, iu referua Ligjit Nr. 04/L-131 për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti, Ligjit Nr.08/L-248 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-131 Për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti, të publikuar në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, duke

analizuar raportin ndërmjet aktit ligjor dhe atij nënligjor në dritën e parimit të hierarkisë së normave juridike dhe kufijve të autorizimit ligjor.

Për të vlerësuar ligjshmërinë e dispozitës së aktit nënligjor normativ, gjykata iu referua Ligjit Nr. 04/L-13 për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti, përkatësisht nenit 8 paragrafi 1 me të cilin është përcaktuar se: *“Të drejtën në pension kontribut pagues të moshës e realizojnë të gjithë personat të cilët kanë shtetësi të Kosovës dhe të cilët: 1.1. kanë mbushur moshën gjashtëdhjetë e pesë (65) vjeçare; 1.2. duhet të ketë stazh pensional kontribut dhënës, sipas Ligjit për Sigurimin Pensional dhe Invalidor nr. 011-24/83 (Gazeta Zyrtare e KSAK nr.26/83) para datës 01.01.1999; 1.3. ofrojnë dëshmi të vlefshme mbi pagesën e kontributeve sipas dispozitave të Ligjit për Sigurimin Pensional dhe Invalidor nr.011-24/83 (Gazeta Zyrtare e KSAK nr.26/83) para datës 01.01.1999”*. Paragrafit 6 të po këtij neni me të cilin është përcaktuar se: *“Me këtë ligj u njihet stazhi i punës për pension kontribut dhënës për vitet 1989-1999 punëtorëve të arsimit, të shëndetësisë dhe të tjerëve që kanë punuar në sistemin e Republikës së Kosovës”*.

Ndërsa me Udhëzimin Administrativ Nr. 09/2015 për Kategorizimin e Shfrytëzuesve të Pensionit Kontributpagues sipas Strukturës Kualifikuese dhe Kohëzgjatjes së Pagesës së Kontributeve - Stazhit Pensional, përkatësisht nenit 5 paragraf 5 të tij, me të cilin është përcaktuar se: *“Të gjitha dëshmitë për kualifikim, të përcaktuara nga paragrafët 2,3 dhe 4 të këtij neni, duhet të jenë para vitit 01.01.1991”*. Paragrafët 2,3 dhe 4 përcaktojnë *“2. Shfrytëzuesi i pensionit kontributpagues me përgatitje shkollë të mesme, konsiderohet pensionisti, përkatësisht i siguruari i cili ka të kryer shkollën e mesme. 3. Shfrytëzuesi i pensionit kontributpagues me përgatitje shkollë të lartë, konsiderohet pensionisti, përkatësisht i siguruari i cili ka të kryer shkollimin e lartë. 4. Shfrytëzuesi i pensionit kontributpagues me përgatitje shkollë superiore, konsiderohet pensionisti, përkatësisht i siguruari i cili ka të kryer fakultetin apo studimet pasuniversitare.*

Nën dritën e interpretimit të këtyre dispozitave ligjore, gjykata vlerëson se neni 8 paragrafi 1 i ligjit bazik për skemat pensionale të financuara nga shteti, rezulton se e drejta në pension kontributpagues të moshës kushtëzohet me plotësimin e kriterëve themelore, përkatësisht: arritjen e moshës 65 vjeçare, ekzistimin e stazhit pensional kontributpagues para datës 01.01.1999, si dhe paraqitjen e dëshmive të vlefshme për pagesën e kontributeve sipas legjislacionit përkatës. Ndërsa, me paragrafin 2 të nenit 8 të këtij ligji, ministria kompetente

është autorizuar që me akt nënligjor të përcaktojë kategorizimin e shfrytëzuesve të pensionit kontributpagues sipas strukturës kualifikuese, kohëzgjatjes së kontributeve dhe kriterëve të tjera.

Gjykata vlerëson se ky autorizim ligjor ka karakter të kufizuar dhe nuk mund të interpretohet si bazë për krijimin e normave të reja materiale, të cilat kufizojnë ose ndryshojnë përmbajtjen e të drejtave të përcaktuara me ligj. Në këtë kuptim, akti nënligjor duhet të jetë në funksion të zbatimit të ligjit dhe në përputhje të plotë me të, pa tejkaluar kufijtë e autorizimit të dhënë. Në rastin konkret, me nenin 5 paragrafi 5 të Udhëzimit Administrativ Nr. 09/2015 është përcaktuar se të gjitha dëshmitë për kualifikim duhet të jenë para datës 01.01.1991. Gjykata konstaton se një kufizim i tillë kohor nuk është i paraparë me asnjë dispozitë të ligjit bazë dhe nuk rrjedh nga qëllimi apo struktura e tij. Përkundrazi, ligji lidh të drejtën në pension dhe lartësinë e tij me kontributet e paguara deri më 01.01.1999, dhe jo me kohën e fitimit të kualifikimit arsimor.

Gjykata Supreme, në shqyrtimin e ligjshmërisë së dispozitës së kontestuar, iu referua gjithashtu Nenit 8/A të Ligjit Nr. 08/L-248 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-131, i cili rregullon pensionin parcial kontributpagues të moshës për personat që nuk arrijnë stazhin minimal prej pesëmbëdhjetë (15) vitesh për shkak të largimeve të dhunshme nga puna. Ky nen pasqyron qartë vullnetin e ligjvënësit për të siguruar instrumente fleksibël që mbrojnë të drejtat e individëve dhe për të adresuar situata të veçanta sociale dhe historike, duke mundësuar përfshirjen e personave që kanë përmbushur pjesërisht kushtet për pension për shkak të pengesave objektive. Në kundërshtim me këtë, Neni 5 paragrafi 5 i Udhëzimit Administrativ Nr. 09/2015 vendos një kufizim të ngushtë kohor, duke kërkuar që të gjitha dëshmitë për kualifikim të jenë para datës 01.01.1991, pa dhënë asnjë arsyetim objektiv, social apo historik për këtë kufizim. Kjo dallon qartë nga fryma dhe qëllimi i ligjit bazik, i cili synon trajtim të drejtë dhe proporcional të individëve, duke përfshirë ata që për shkak të rrethanave të jashtëzakonshme mund të mos kenë përmbushur kriteret formale brenda një periudhe të caktuar. Në këtë kontekst, referimi në Nenin 8/A fuqizon arsyetimin e Gjykatës se kufizimi i vendosur nga Udhëzimi Administrativ është i pabazuar, arbitrar dhe tejkalon autorizimin ligjor, pasi ligji vetë parashikon fleksibilitet dhe përjashtime që mbrojnë të drejtat e individëve, duke siguruar përputhshmërinë me parimet e ligjshmërisë, proporcionalitetit dhe barazisë.

Gjykata gjithashtu iu referua Neni 3 të Ligjit për Përkufizime, i cili përcakton qartë kuptimin e “pensionit kontributpagues të moshës” si pension mujor për qytetarët e punësuar në Republikën e Kosovës që kanë paguar kontributet në ish-Fondin Pensional të Kosovës para datës 01.01.1999 sipas Ligjit për Sigurimin Pensional dhe Invalidor nr. 011-24/83 dhe që plotësojnë kriteret e parashikuara me ligj. Ky përkufizim ilustron se ligjvënësi e ka lidhur të drejtën në pension me kontributin real të paguar dhe plotësimin e kushteve ligjore, pa bërë asnjë lidhje me kohën e fitimit të kualifikimeve arsimore. Në këtë mënyrë, vendosja e një kufizimi të veçantë kohor nga Udhëzimi Administrativ (para 01.01.1991) nuk ka bazë ligjore dhe bie ndesh me parimin e ligjshmërisë dhe të trajtimit të barabartë, duke theksuar tejkalimin e autorizimit të dhënë nga ligji.

Në vlerësimin e mëtejshëm, gjykata i referohet edhe standardeve kushtetuese për barazi dhe mosdiskriminim, të cilat kërkojnë që çdo dallim në trajtim duhet të plotësojë tri kriteret themelore: (i) të jetë i përcaktuar me ligj; (ii) të ndjekë një qëllim legjitim; dhe (iii) të jetë proporcional në raport me qëllimin e synuar.

Ndërlidhur me këtë, gjykata fillimisht konstaton se kufizimi i paraparë me nenin 5 paragrafi 5 të Udhëzimit Administrativ Nr. 09/2015, i cili kushtëzon vlefshmërinë e kualifikimit arsimor me datën 01.01.1991, nuk është i përcaktuar me ligj, por vetëm me akt nënligjor. Ligji bazë për skemat pensionale nuk përmban asnjë dispozitë që e lidh njohjen e kualifikimit arsimor me një kufizim kohor të tillë, por përkundrazi e bazon të drejtën në pension dhe përfitimet që rrjedhin nga ai në ekzistimin e kontributeve të paguara deri më 01.01.1999. Në këtë kuptim, organi administrativ, duke vendosur një kriter të ri që nuk rrjedh nga ligji, ka tejkaluar kufijtë e autorizimit të dhënë dhe ka ndërhyrë në përmbajtjen materiale të së drejtës, çka bie ndesh me parimin e ligjshmërisë dhe hierarkisë së normave juridike.

Tutje, gjykata vlerëson se nuk është dëshmuar nga e paditura, ekzistimi i ndonjë qëllimi legjitim që do të mund të arsyetonte vendosjen e datës 01.01.1991 si kufi për vlefshmërinë e diplomave dhe kualifikimeve arsimore. As nga akti nënligjor, as nga qëndrimet e organit administrativ, nuk rezulton ndonjë arsyetim objektiv, ekonomik apo social që do të lidhte këtë datë me funksionimin e sistemit pensional apo me qëllimin e ligjit për sigurimin e një skeme të drejtë dhe të qëndrueshme pensionale. Në mungesë të një arsyeimi të tillë, kufizimi paraqitet si arbitrar dhe i pambështetur në ndonjë nevojë reale shoqërore apo interes publik.

Në aspektin e proporcionalitetit, gjykata vlerëson se masa e ndërmarrë është joproporcionale, pasi që përjashton në mënyrë të përgjithshme një kategori të tërë pensionistësh kontributpagues, të cilët kanë përmbushur kushtet ligjore për pension dhe kanë kontribuar në sistemin pensional, vetëm për shkak të kohës së fitimit të kualifikimit të tyre arsimor. Një përjashtim i tillë nuk është i kufizuar apo i balancuar, por prek drejtpërdrejt thelbin e të drejtës për trajtim të barabartë në përcaktimin e lartësisë së pensionit, duke mos marrë parasysh kontributin real dhe stazhin pensional të individëve të prekur.

Gjykata vlerëson se vendosja e një kriteri të tillë nga ana e organit administrativ përbën tejkalim të autorizimit ligjor, pasi që krijon një kusht të ri material për njohjen e kualifikimit arsimor, i cili ndikon drejtpërdrejt në lartësinë e pensionit kontributpagues. Një veprim i tillë është në kundërshtim me parimin e hierarkisë së normave juridike, sipas të cilit aktet nënligjore nuk mund të ndryshojnë, kufizojnë apo plotësojnë të drejtat e përcaktuara me ligj. Po ashtu, gjykata vlerëson se kufizimi i vlefshmërisë së kualifikimit arsimor vetëm për personat që kanë diplomuar para datës 01.01.1991 krijon dallim në trajtim ndërmjet kategorive të pensionistëve kontributpagues, të cilët ndodhen në situata të njëjta sa i përket pagesës së kontributeve dhe përmbushjes së kushteve ligjore. Një dallim i tillë nuk është i bazuar në kriterë objektive dhe të arsyeshme dhe nuk është proporcional me qëllimin e ligjit, duke cenuar kështu parimin e barazisë para ligjit dhe sigurinë juridike.

Gjykata Supreme e Kosovës, gjatë shqyrtimit të çështjes konkrete, kishte parasysh pretendimet e palës së paditur, sipas të cilave lidhur me dispozitën nënligjore të kontestuar tashmë ka vendosur Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës përmes Aktgjykimit KO190/19, të datës 16 janar 2023. Në këtë drejtim, pala e paditur ka pretenduar se kjo çështje është trajtuar dhe zgjidhur në mënyrë përfundimtare nga Gjykata Kushtetuese, duke nënkuptuar se e njëjta nuk mund të rishqyrtohet më tej.

Megjithatë, pas një analize të kujdesshme të përmbajtjes së aktgjykimit të lartpërmendur, Gjykata Supreme vlerëson se Gjykata Kushtetuese, në atë rast, nuk ka shqyrtuar në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe meritore dispozitën konkrete nënligjore që është objekt i këtij kontesti. Përkatësisht, sipas vlerësimit të kësaj gjykate, Aktgjykimi KO190/19 nuk përmban qëndrim specifik lidhur me ligjshmërinë apo kushtetutshmërinë e dispozitës së kontestuar në këtë procedurë. Rrjedhimisht, pretendimet e palës së paditur nuk mund të konsiderohen të bazuara në këtë aspekt, për faktin se mungon një vendimmarrje e qartë dhe e drejtpërdrejtë e Gjykatës

Kushtetuese mbi këtë çështje konkrete. Si pasojë, Gjykata Supreme vlerëson se nuk ekziston pengesë juridike për shqyrtimin dhe vendosjen lidhur me dispozitën nënligjore në fjalë në kuadër të kësaj procedure. (shiko: Aktgjykimin KO190/19, të datës 16 janar 2023, të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, pika 272).

Në fund, Gjykata vlerëson se Ligji për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti përcakton, qartë llojet e pensioneve, kriteret dhe procedurat administrative që duhet të ndiqen për të njohur të drejtën në secilën kategori pensioni. Në lidhje me llojet e pensioneve, neni 4 i Ligjit në fjalë përcakton edhe: pensionin kontributpagues të moshës, ndërsa nenet pasuese të Ligjit saktësojnë kushtet dhe kriteret për secilën nga këto kategori, ndërsa neni 19 përcakton procedurat administrative që duhet të ndiqen nga personat që kërkojnë njohjen e të drejtës në pension, duke përfshirë afatet për dorëzimin e kërkesave dhe ankesave lidhur me njohjen ose mosnjohjen e të drejtës. Në lidhje me këtë kategori, neni 8 përcakton tri kriteret kryesore për njohjen e të drejtës: personi të ketë shtetësi të Kosovës dhe të ketë mbushur moshën 65 vjeç; të ketë stazh pensional kontribut dhënës sipas Ligjit të ish KSAK-së para 1 janarit 1999; të paraqesë dëshmi të vlefshme për pagesën e kontributeve sipas dispozitave të Ligjit të ish KSAK-së. Paragrafi 2 i nenit 8 parashikon gjithashtu që kategorizimi i përfituesve të këtij pensioni të bëhet me akt nënligjor, duke marrë parasysh kohëzgjatjen e pagesës së kontributeve dhe kriteret e tjera. Udhëzimi Administrativ nr. 09/2015 i MPMS përcakton kategorizimin e shfrytëzuesve sipas strukturës kualifikuese dhe kohëzgjatjes së kontributeve. Sipas këtij Udhëzimi Administrativ përcaktohen: Kategorizimi, kualifikimi dhe dokumentet e nevojshme për njohjen e të drejtës në pension kontribut pagues (nene 4 deri 7) dhe Procedurat administrative për njohjen dhe realizimin e pensionit (nene 10 deri 13).

Gjykata vlerëson se vendosja e kufizimit të vitit 1991 si datë përfundimi e vlefshmërisë së kualifikimeve arsimore nga Udhëzimi Administrativ Nr. 09/2015 nuk ka bazë ligjore. Ligji Nr. 04/L-131 dhe Ligji Nr. 08/L-248 nuk e lidhin të drejtën në pension me datën e fitimit të kualifikimit arsimor, por vetëm me pagesat e kontributeve deri më 01.01.1999 dhe stazhin minimal, duke përfshirë edhe individët që nuk e arritën stazhin për shkak të largimeve të dhunshme (Neni 8/A). Në këtë kuptim, kufizimi para vitit 1991 nuk është i përcaktuar me ligj dhe nuk ndjek ndonjë qëllim legjitim të skemës pensionale. Përkundrazi, ai krijon një dallim arbitrar në trajtim midis shfrytëzuesve të pensionit kontributpagues, duke penalizuar individë që plotësojnë të gjitha kriteret ligjore për pension, por kanë përfunduar kualifikimin arsimor pas vitit 1991.

Duke u bazuar në të lartcekurat, gjykata arrin në përfundimin se dispozita e nenit 5 paragrafi 5 të Udhëzimit Administrativ Nr.09/2015 (MPMS), për Kategorizimin e Shfrytëzuesve të Pensionit Kontributpagues sipas Strukturës Kualifikuese dhe Kohëzgjatjes së Pagesës së Kontributeve - Stazhit Pensional, është në kundërshtim me Ligjin Nr. 04/L-131 për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti, tejkalon autorizimin e dhënë me ligj dhe cenon parimet themelore të rendit juridik, për çka e njëjta duhet të shpallet e paligjshme dhe të shfuqizohet.

V. Vlerësimi i gjykatës mbi kërkesat akcesore

Lidhur me shpenzimet e procedurës:

Vendimin që pala e paditur të ia kompensoj paditësit shpenzimet e procedurës, gjykata e ka mbështetur në dispozitat e nenit 101 paragraf 1 të LKA-së, dhe nenit 7 numri tarifor 7 të Rregullores për tarifat e Avokatisë, miratuar nga Kuvendi i Odës së Avokatëve të Kosovës në Prishtinë, datë 27 dhjetor 2025, dhe atë: për taksë gjyqësore: shumën në lartësi prej 250 (dyqind e pesëdhjetë) Euro, për përpilimin e padisë: shumën në lartësi prej 160 (njëqind e gjashtëdhjetë) Euro, dhe për një seancë gjyqësore të mbajtur: shumën në lartësi prej 208 (dyqind e tetë) Euro, në lartësi të përgjithshme: prej 618 (gjashtëqind e tetëmbëdhjetë) Euro. Meqenëse lartësia e shpenzimeve të procedurës është specifikuar sipas parashtresës së dorëzuar nga i autorizuari i paditësit, gjykata vendosi për lartësinë e kompensimit brenda kufijve të treguar në parashtresë.

Lidhur me publikimin e aktgjykimit:

Lidhur me publikimin e aktgjykimit, gjykata vendosi në përputhje me nenin 70 paragrafi 2 të Ligjit për Konfliktet Administrativ. Në bazë të këtij neni, i cili përcakton se: Aktgjykimi i arsyetuar dhe pasi ka marrë formë të prerë, publikohet në të njëjtën mënyrë në të cilën është publikuar vetë akti, për efekt të hyrjes në fuqi. Bazuar në këtë dispozitë ligjore gjykata vendosi si në pikën V të dispozitivit të këtij aktgjykimi. Publikimi i aktgjykimit kontribuon në transparencën e punës së gjykatës, në forcimin e parimit të sigurisë juridike, si dhe në udhëzimin e autoriteteve publike dhe qytetarëve lidhur me të drejtën dhe praktikën administrative. Andaj, gjykata vlerësoi se është e nevojshme që ky aktgjykim të bëhet i qasshëm për publikun, në mënyrën e njëjtë të publikimit të aktit nënligjor normativ për efekt të hyrjes në fuqi, konform nenit 70 paragrafi 2 të LKA-së.

Duke u bazuar në të lartë cekurat, gjykata konform dispozitave ligjore të nenit 10 paragraf 4, neni 11 paragrafi 3, neni 59, neni 70 të LKA-së, ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS

P.A.nr.1/2026, të datës 17.03.2026

B. Profesionale

Zanë Buçinca

Kryetare e kolegjit

Delushe Halimi

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi nuk është e lejuar ankesa.

(neni 10 paragraf 4 i LKA-së)